

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Wadephul: Është e drejtë që ne të flasim me njëri-tjetrin
ADRESA	https://www.cna.al/kosova-bota/wadephul-shte-e-drejte-qe-ne-te-flasim-me-njeri-tjetrin-i-475306
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 06:41:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 06:32:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0945b2187e5816be0992b1834e150c09c809799acf9e94dd01adaf593cdc6e7d
TEKSTI	8dec089a38dd8a0f4cc3174b62a78f27cbb4c297c314caf09187acd39a183c39
PAMJA	95ee3f1604a384806f2f59a1161bd184d0d08ead2d3a47482539962d2bf454c4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4371e9f179288d83ad49fb04b51665ebcc94cb4ef517532fb2a424542cfa031e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f5063896df89cef7c197e5d003e6be2f1d9963e4417c199c978c5a8c380b40e8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4371e9f179288d83ad49fb04b51665ebcc94cb4ef517532fb2a424542cfa031e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

08:32 Kosova & Bota

Ishte takimi i parë mes dy kryediplomatëve të Gjermanisë d...

Wadephul: Është e drejtë që ne të flasim me njëri-tjetrin



27 Shtator 2026, 08:32, Kosova & Bota CNA



Ishte takimi i parë mes dy kryediplomatëve të Gjermanisë dhe Rusisë që nga fillimi i agresionit rus kundër Ukrainës. Si erdhi deri te takimi me Lavrovin dhe si e vlerëson Wadephul

Ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Johann Wadepul, është takuar papritur me homologun e tij rus, Sergej Lavrov, në kuadër të debatit të përgjithshëm të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në Nju Jork. Biseda, që zgjati rreth 20 minuta dhe ishte takimi i parë dypalësh midis ministrave të Jashtëm të të dy vendeve pas disa vitesh, u organizua, sipas Wadepulit, me ndërmjetësimin e palëve të treta.

"Jam kontaktuar nga shumë kolegë të vendeve të tjera dhe më është thënë se Rusia ishte e gatshme për një bisedë", tha ministri i Jashtëm gjerman në një intervistë për emisionin gjerman të ARD-së, tagesthemen. Sipas tij, shumë prej tyre e këshilluan ta zhvillonte këtë takim dhe madje ia kërkuan një gjë të tillë.

"U kalua një vijë e kuqe"

Përmbajtja e bisedës u përqendrua te pasojat e luftës agresive të Rusisë kundër Ukrainës. Sipas Wadepulit, një nga çështjet kryesore ishte eksporti i drithërave nga Ukraina dhe Rusia. "Një vend si Egjipti ka nevojë urgjente për diçka të tillë. Ekziston rreziku i urisë", tha ministri gjerman i Jashtëm. Angazhimi për të garantuar këto eksporte është, sipas tij, gjëja e duhur për t'u bërë.

Tema e dytë ishte incidenti me dronin në aeroportin Leipzig/Halle. "Një dron, i cili realisht mund të kishte shkaktuar rrezimin e avionëve, është vënë në përdorim atje nga duar ruse", tha Wadepul.

Ai theksoi se ia kishte bërë të qartë Lavrovit se "me këtë është kaluar një vijë e kuqe" dhe se Gjermania pret që një gjë e tillë të mos përsëritet. "Ne jemi gjithmonë të gatshëm të reagojmë", paralajmëroi ministri gjerman i Jashtëm.

Qeveria federale gjermane e konsideron Rusinë përgjegjëse për incidentin me një dron të pajisur me lëndë shpërthyesë që nuk arriti të shpërthejë në aeroportin Leipzig/Halle, një nyje logjistike me rëndësi të madhe për mbështetjen e Ukrainës. Sipas Berlinit zyrtar, droni paraqiste një rrezik serioz për trafikun ajror dhe mund të kishte shkaktuar pasoja të rënda. Autoritetet gjermane e lidhin incidentin me veprime ruse dhe e shohin atë si një përshkallëzim të papranueshëm.

Së treti, Wadepul tha se i kishte bërë të qartë Lavrovit se mbështetja gjermane për Ukrainën mbetet e palëkundur. "Kjo mbështetje është plotësisht e pandërprerë", theksoi ministri i Jashtëm gjerman, duke shtuar se tani është Rusia ajo që duhet të ulet në tryezën e negociatave. "Nuk ka asnjë justifikim për këtë luftë, e cila po merr jetë të panumërta njerëzish, përfshirë edhe viktimat ruse, por mbi të gjitha viktimat civile në Ukrainë", deklaroi Wadepul.

Jo ndryshim i politikës së jashtme gjermane

Sipas ministrit të Jashtëm gjerman, ndërsa Gjermania do të vazhdojë të mbështesë Ukrainën përballë agresionit rus. "Është e drejtë që ne të flasim me njëri-tjetrin", tha më tej Wadepul. Sipas tij, Rusia aktualisht nuk është e gatshme t'i japë fund luftës kundër Ukrainës. "Megjithatë, unë besoj se është e drejtë që ne të vazhdojmë të bisedojmë me njëri-tjetrin. Kjo është detyra e ministrave të jashtme dhe e diplomacisë", theksoi ministri i Jashtëm gjerman.


Pranimin e një bisede të drejtpërdrejtë me Lavrovin, Wadepul nuk e sheh si një ndryshim të kursit në politikën e jashtme gjermane. Gjermania vazhdon të mbrojë të drejtën ndërkombëtare dhe të qëndrojë në krah të Ukrainës. Këtë qëndrim, tha ai, ia bëri të qartë edhe një herë ministrit të Jashtëm rus gjatë takimit. "E dini, me miqtë nuk negociohet, ndërsa me kundërshtarët duhet të negociohet. Ky është një nga parimet themelore të politikës së jashtme dhe ai vlen edhe në këtë rast", tha Wadepul.

Ministri i Jashtëm rus, Sergej Lavrov, e vuri menjëherë në pikëpyetje dobinë e takimit dhe tha se nuk kishte parë asnjë përparim konkret. Në një deklaratë për agjencinë gjermane të lajmeve dpa, Lavrov u shpreh: "Nëse shihen deklaratat e përditshme publike të Berlinit, nuk kam dëgjuar asgjë ndryshe." Sipas tij, qëndrimet e paraqitura nga pala gjermane ishin tashmë të njohura dhe nuk sollën asgjë të re. "Mund të më kishin telefonuar thjesht", shtoi kryediplomati rus.

Fjalim mbi rreziqet e inteligjencës artificiale

Wadepul kishte udhëtuar në Nju Jork si përfaqësues i kancelarit federal Friedrich Merz. Në fjalimin e tij para Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, ai u përqendrua te rreziqet që vijnë nga zhvillimi jashtëzakonisht i shpejtë i inteligjencës artificiale.

Ministri i Jashtëm gjerman paralajmëroi se përparimi i vullshëm i teknologjive të inteligjencës artificiale sjell jo vetëm mundësi të mëdha, por edhe sfida serioze për sigurinë, stabilitetin dhe rendin ndërkombëtar. Së bashku, vendet anëtare të Kombeve të Bashkuara duhet të sigurojnë që inteligjenca artificiale "t'i shërbejë dinjitetit njerëzor", theksoi Wadepul në fjalimin e tij para Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së./ DW





Të sugjeruara

Panelet diellore funksionojnë edhe 10 metra nën det, shkencëtarët testojnë teknologjinë e re

Zgjedhjet në Bosnje nën vëzhgimin e figurave të afërta me Kremlinin

Trump refuzon planin iranian për rihapjen e Ngushticës së Hormuzit

Shpërthimi në Athinë/ Rritet bilanci i viktimave, 6 persona humbin jetën

Italia ndalon burkat në shkolla

Partitë ekstremiste po lulëzojnë dhe kjo i tremb njerëzit

Irani i propozon marrëveshje SHBA-së për të rihapur Ngushticën e Hormuzit brenda shtatë ditësh

Kishte destinacion Kosovën/ Mali i Zi ndalon ngarkesën me mish të skaduar

U qëllua me armë gjatë një tubimi të Trump në Pensilvani/ 76-vjeçari humb jetën pas dy vitesh

Bundestagu gjerman miraton zbritjen e taksës së karburantit

Në disa qytete të Kosovës protestohet kundër dënimit të ish-krerëve të UÇK-së

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së/ Nisma për ndryshimin e ligjit të "Speciales" dërgohet për mendim në Qeveri

Takimi Trump-Xi: Fanfara, paradë, bankete dhe pak rezultate

Greqia po përpiqet të rikthejë punëtorët e kualifikuar

Ekonomia gjermane po rimëkëmbet, por për sa kohë?

Dyshohet për krime në kampin nazist të të burgosurve të luftës/ Nisin hetimet ndaj 105-vjeçarit në Gjermani

FOTO/ Dhjetëra delegatë braktisin sallën e OKB-së sapo Netanyahu merr fjalën

I shiti Pentagonit softuer për hakimin e telefonave/ Kompania rezulton me pronësi ruse

Rekord i ri për vitin 2026/ Ja sa emigrantë kanë kaluar brenda një dite Kanalin Anglez


Rikthimi i Turqisë në programin F-35/ Erdogan: Trump është pozitiv për këtë perspektivë

[editorial](#)

09:11 Editorial Bujar Leskaj

Të ndihmojmë SHISH-in të mbrojë shtetin nga krimi, dhe jo krimin nga shteti!!

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

[opinion](#)

07:33 Opinione Sadik Bejko

Rasputin, patronazhizmi seksual

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.